

Akt Themelimi
I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
"P.B.AL" SH.P.K

Ne Tirane, sot me date 22 Janar 2024, ne themeluesit:

Stivson Memisha i biri i Luanit, i dtl. 19.05.1978, lindur ne , Tepelene, Shqiperi dhe banues ne Grabian, Ndertesa Nr.55, Hyrja 4 Ap 4.kodi postar 9011, Divjake, Shqiperi, shtetas shqipetar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr. H80519117K, i cili me cilesine e "ortakut themelues ", me vullnet të lire, të plote e të singerte hartoje kete akti themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "P.B.AL." SH.P.K. (me poshte e quajtur "Shoqeria mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

Siri Sinani i biri i, Seit i dtl. 23.12.1963, lindur ne , Tepelene, Shqiperi dhe banues ne Rr.Muedin Llagami, pallati Vala.Hyrja 31, Tirane, Shqiperi, shtetas shqipetar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr. G21223066N, i cili me cilesine e "ortakut themelues ", me vullnet të lire, të plote e të singerte hartoje kete akti themelimi per krijimin e shoqerise pergjegjesi te kufizuar me emertimin "P.B.AL " SH.P.K. (me poshte e quajtur "Shoqeria mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "P.B.AL" SH.P.K, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "P.B.AL " SH.P.K, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaket", te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne kuotat e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Stivson Memisha
9/0

Siri Sinani
del

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë kryesore në Tiranë, në adresën : Tiranë, Njesia Administrative 12, Linze, Rruga e Teleferikut, Numri i Pasurisë ,219/22+6-G11, Zona kadastrale 2460. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të saj.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Prodhimi dhe tregëtim të mjeteve për bletari . prodhimin e zgjojve për bletë , korniza bletësh në mënyrë industriale, për prodhimin e ushqimeve artificiale për bletë prodhimin e detaleve dhe mjeteve plastike për bletari, prodhimin të poliestreve për zgjojt për bletë.

Import-eksport të Produkteve dhe pajisjeve për bletarinë,dhe të aksesoreve në ndihmë të fushës së bletarisë. Kultivimi i Bletarisë dhe kryerja e kurseve profesionale kualifikimi , për bletarinë .

Shoqëria do të ushtrojë të gjitha aktivitetet të lejuara nga ligji, duke përfshirë edhe prodhimin, punëtorinë dhe shërbimet të krijuara nga shoqëria vetë. Shërbime telekomunikacioni, shërbime në komunikimet web, foto, dhe shërbime kundrejt shoqërive që merren me komunikimet web. Importe-eksporte, tregtimin e të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, makinerive, automjeteve, pajisjeve.

Importi i pajisjeve frigoriferike, furrave, paneleve diellore, sistemeve elektrike për mbrojtje në perimetritë të parqeve të bletarisë nga kafshët .Prodhimi i karrocërve për transportin dhe mbajtjen e bletëve.

Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në dy kuota, kontribut i ortakëve themelues në masën:

Z. Stivson Luan Memisha, është zotëruar i 1 kuote me vlerë 50,000 leke, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Siri Sinani, është zotëruar i 1 kuote me vlerë 50,000 leke, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë për kundrejt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Stivson Memisha
sp

Siri Sinani
ak

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakeve është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqërisë.

Asambleja e ortakeve , vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Stinson Mamishy
9/10

Arat Sunani
ak

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë është Z. **Stivson Luan Memisha**, i biri i Luanit, i dtl. 19.05.1978, lindur në Tepelene, Shqipëri dhe banues në Grabian, Ndertesa Nr.55, Hyrja 4 Ap 4. Kodi postar 9011, Divjake shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar nepermjet kartës së identitetit me nr. H80519117K.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejta ripërteritje.

Administratori emrohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakeve të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emrohet edhe një person i tretë jashtë ortakeve.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakët i vetëm;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së ortakeve edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Stivson Memisha

Stivson Memisha

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e ortakeve, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.

Stevan Ramishy
GA

Arvi Sinani
dep

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2023.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Asambleja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Ky Akt themelimi i shoqerise "P.B.AL" SH.P.K. u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakeve themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE

Z.STIVSON MEMISHA Z. SIRI SINANI

Stivson Memisha
SP

Siri Sinani
dit
22/01/2024